



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia Org. Org. Unit	SP-02
Nr. i Faqeve Pr. Stranica No. Pages	04
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	1784-2/25
Data: Datum: Date:	26.05.25
PRISHTINË / A	
No. 1	

DATË/A:	06.05.2025
REFERENC-Ë:	25/1784/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Energy Development Group-Kosova L.L.C." Sh.p.k. Prishtinë, Parku i Energjisë Diellore në lokalitetin Madanaj-Rrypaj, Komuna e Gjakovës
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për vazhdim të Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për vazhdimin e Lejes Mjedisore të operatorit "Energy Development Group-Kosova L.L.C.", Sh.p.k. Prishtinë, Parku i Energjisë Diellore në lokalitetin Madanaj-Rrypaj, Komuna e Gjakovës.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/1784/MMPHI
Datë: 06.05.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 2, 4 të nenit 12 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatori "Energy Development Group-Kosova L.L.C." Sh.p.k. Prishtinë, me nr. prot. 25/1784/MMPHI, pajiset me Leje Mjedisore për veprimtarinë: Parku i Energjisë Diellore në ngastrat me nr.00070-2 dhe nr.00071-20, vendi i quajtur Madanaj-Rripaj, zona kadastrale Kodra e Hutit, Komuna e Gjakovës.
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Të mirëmbahen shtresat antirefletuese në modulet solare, ku janë të vendosura qelqet ballore speciale për të ndaluar reflektimin e dritës;
 - 2.3. Të mirëmbahen pajisjet kundër zjarrit;
 - 2.4. Për sistemin menaxhues të mjedisit të ketë personin përgjegjës të profilit mjedisor;

- 2.5. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe aktivitetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin, "Energy Development Group-Kosova L.L.C." Sh.p.k. Prishtinë, me nr. prot. 25/1784/MMPHI, për veprimtarinë: Parku i Energjisë Diellore, Kusar, K. Gjakovë, në ngastrat në ngastrat me nr. 00070-2 dhe nr. 00071-20, vendi i quajtur Madanaj-Rripaj, zona kadastrale Kodra e Hutit, Komuna e Gjakovës, konstatohet që operatori plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për vazhdimin e Lejes Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me nr.22/7707/1-ZSP/74/23, të lëshuar me datë: 03.02.2023;
- Aktvendim për ndërtimin – montimin e Paneleve Solare me kapacitet prej 7.5 MWh, nga drejtoria për Urbanizëm, K. Gjakovë, nr.07/351/02-28581/2022, të lëshuar me datë:16.03.2023
- Vendim nga ZRRE, V_2559_2024, 12.11.2024

Andaj bazuar në të cekurat më lartë dhe gjendjes faktike në teren, si dhe plotësimit të kushteve të parapara me legjislacionin mjedisor, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr **Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.**

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Gjakovë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së